



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:155146
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05634415

PPP.nr.178/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përmbarimore të kreditorit F. SH.P.K, me seli në fsh ..., Komuna e Ferizajt, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor Sh.Q. nga Ferizaj, e këtë e përfaqëson av Edison Simani nga Vitia, kundër debitorit E.L.K. nga fsh, Komuna e Shtimes, të cilin e përfaqëson av Kemajl Ademaj nga Ferizaj, për pagesën e borxhit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga i autorizuari i debitorit, më datë 29.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.PRANOHET në tërësi si i bazuar prapësimi i të autorizuarit të debitorit E.K., i ushtruar kundër urdhrit për përmbarim P.nr.117/22, të datës 11.05.2022, i lëshuar nga Përmbaruesi privat P.Xh. nga Gjilani dhe **SHFUQIZOHET** në tërësi urdhri për përmbarim P.nr.117/22, i datës 11.05.2022, **ANULOHEN** në tërësi veprimet e kryera përmbarimore sipas urdhrit P.nr.117/22, të datës 11.05.2022, si dhe **PËRFUNDOHET** në tërësi përmbarimi në lëndën përmbarimore P.nr.117/22.

II.DETYROHET kreditori F. SH.P.K, që debitorit E.K., t'ia paguaj shpenzimet për përpilimin e prapësimit në shumë prej 312 euro, dhe shumë prej 21 euro në emër të taksës gjyqësore për prapësim, në shumë të përgjithshme prej 333.00 euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat P.Xh., duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit F. SH.P.K, me urdhrin P.nr.117/22, të datës 11.05.2022 e ka caktuar përmbarimin ndaj debitorit E.L.K., për pagesën e borxhit ndaj kreditorit në shumë prej 21,719.00 euro dhe shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbarim në shumë prej 312 euro, si dhe shpenzimet tjera të përmbarimit, në pajtim me udhëzimin e administrativ Nr.06/2014, në bazë të Para Kontratës për Shitblerjen e Paluajtshmërisë-Banesës, LRP.nr.2.../2017, Ref.nr.7.../2017, e datës 10.08.2016, ose bllokimin e të gjitha llogarive bankare nëpër të gjitha bankat komerciale në Kosovë, ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale.

Kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit, në afatin ligjor, ka ushtruar prapësim i autorizuari i debitorit, me të cilin i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi si i bazuar.

I autorizuari i kreditorit ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të autorizuarit të debitorit dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

Prapësimi i debitorit është i bazuar

Sa i përket pretendimeve të autorizuarit të debitorit në prapësim se : dokumenti përmbarimor i përmendur në propozim nuk mundë të përmbarohet në kuptim të nenit 26, të LPP-së, pasi që debitori i ka përmbushur të gjitha detyrimet ndaj kreditorit ashtu siç janë përcaktuar në dokumentin përmbarimor, nga dokumenti përmbarimor – kontrata, sipas nenit 2, palët kanë caktuar çmimin e shitblerjes prej 33,719.00 euro, ashtu që pagesa të bëhet përmes llogarisë bankare, me afat pagese 4,500.00 euro dy ditë pas lidhjes së kontratës, 25,000.00 euro deri në fund të shtatorit 2017 dhe kësti i fundit 3,719.00 euro, me rastin e nënshkrimit të kontratës kryesore. Debitori çmimin e përmendur në nenin 2, të dokumentit përmbarimor e ka përmbushur në tërësi, madje edhe para se të maturohet kërkesa. Në rastin konkret debitori ka përmbushur detyrimin e tijë duke i bërë pagesat si në vijim: Me datë 11.08.2017 shumë prej 4,500 euro, me datë 22.08.2017 shumë prej 10,000 euro, me datë 31.08.2017 shumë prej

3,720 euro, me datë 12.09.2017 shumën prej 7,500 euro dhe përfundimisht me datë 12.09.2017 edhe shumën prej 8,000 euro, gjithsejtë shuma e paguar prej 33,720.00 euro, Gjykata këto pretendime i konsideron të bazuara, sepse nga provat të cilat i ka bashkangjitur prapësimi i autorizuari i debitorit, siç janë fletë transferet bankare të lëshuara nga P.C.B. dhe dy fletë transfere ndërkombëtare, të cilave Gjykata ja ka falur besimin e plotë të provës, siç janë pagesat e bëra në llogarinë e kreditorit F. SHPK nr.1..., në P.C.B. edhe atë: me datë shuma e mjeteve e paguar prej 4,500.00 euro, me datë 22.08.2017 shuma e mjeteve e paguar në shumë prej 10,000.00 euro, me datë 31.08.2017 shuma e mjeteve e paguar prej 3,720.00 euro, me datë 12.09.2017, pagesa këto të lëshuara nga P.C.B., pastaj shuma e mjeteve e paguar prej 7,500.00 euro dhe me datë 12.09.2017 shuma e mjeteve e paguar prej 8,000.00 euro, konstatohet se debitori E.L.K., para nxjerrjes së urdhrin për përmbarim P.nr.117/22, të dt 11.05.2022 nga Përmbaruesi privat P.Xh., e ka përmbushur në tërësi detyrimin e tij i cili rrjedhë nga Para Kontrata LRP.nr.2.../2017, Ref.nr.../2017, e datës 10.08.2016, në vlerë të përgjithshme prej 33,719.00 euro, dhe me këtë Gjykata konstaton se përmbaruesi privat gabimisht ka vendosur kur e ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori me nxjerrjen e urdhrin për përmbarim P.nr.117/22, të datës 11.05.2022.

Si përfundim, Gjykata vlerëson se duke i marr për bazë të gjitha faktet e përmendura më lartë, gjeti se urdhri për përmbarim i nxjerr nga përmbaruesi privat P.Xh., me numër P.nr.117/22, i datës 11.05.2022, është marr në kundërshtim me gjendjen faktike, gjegjësisht pas përmbushjes së plotë të detyrimit nga debitori në raport me kreditorin, andaj edhe gjykata për këtë arsye e pranoj në tërësi si të bazuar prapësimin e të autorizuarit të debitorit, e shfuqizoj urdhrin për përmbarim të cekur më lartë, i anuloj në tërësi veprimet e kryera në bazë të këtij urdhri, si dhe e përfundoj në tërësi përmbarimin në lëndën P.nr.117/22.

Gjykata me rastin e detyrimit të kreditorit që debitorit t'ia paguaj shpenzimet e përpilimit të prapësimi në shumë prej 312 euro dhe shumën e mjeteve prej 21 euro në emër të taksës për prapësim, është bazuar në nenin 13 par, 5, të LPP-së, në të cilin shprehimisht është paraparë: *“Kreditori duhet ti kompensoj debitorit shpenzimet e shkaktuara pa nevojë të justifikueshme”*.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2, 3 dhe 4, të LPP-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.178/22, më datë 29.04.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.